



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE



Nr. 1132/2 , prot.

Tiranë, më 12/10/2021

Drejtuar: Agjencisë së Prokurimit Publik

Tiranë

Lënda: Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

Rektorati i Universitetit të Arteve, shpall konkursin për 2 (dy) vende të lira pune për punonjës mësimorë nga kategoria “As. Lektor” si më poshtë:

I. FAKULTETI I ARTIT SKENIK

➤ NJËSIA BAZË REGJI , REGJI FILMI & TELEVISIONI:

a. As. Lektor për Programin e Studimit Regji Filmi & Tv, 2 vende në lëndët sa mëj poshtë:

a.1. Bazat e Regjisë së filmit

a.2. Regji Filmi;

NJËSIA BAZË REGJI, REGJI FIMI & TELEVISIONI - 2 (dy) punonjës mësimorë;

Sa më poshtë, kërkesat dhe kriteret specifike për sejcilin pozicion pune.

- a.1. Punonjës mësimorë nga kategoria As. Lektor për lëndën Bazat e Regjisë së Filmit - 1 (një) punonjës;
- a.2. Regji Filmi - 1 (një) punonjës;

Kandidati/ët për konkursin e punonjësit mësimorë për lëndët sa më lartë, duhet të plotësojnë këto kritere:

- të ketë kryer studimet në arsimin e lartë në profilin përkatës 4 -vjeçar/ master shkencor ose master në arte (mesatarja e përgjithshme e notave mbi 8) në Universitetin e Arteve. Në rastet kur studimet janë kryer në një shkollë të lartë në arte jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njehsuar në MARS;





DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE

- të ketë përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë në fushën përkatëse, brenda ose jashtë Shqipërie minimumi 3 (tre) vjet;
- të ketë realizuar filma ose dokumentarë televiziv (minimumi 4 të tillë);
- të ketë dëshmi kompjuterike programet Adobe Premierë (paketë e plotë) dhe Final Cut (Paketë e plotë) ;
- të ketë dëshmi të njëjës prej gjuhëve të huaja të BE (Anglisht, Frengjisht, Gjermanisht, Italisht,..etj.);
- të ketë 2 (dy) rekomandime nga profesorë të fushës;
- të dëshmojë etikë të lartë komunikuese, profesionale dhe morale (në përputhje me KE në Uart);
- të mos ketë penalizime nga punëdhënësit e mëparshëm në drejtim të etikës profesionale dhe marrëdhënie me kolegët;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kandidati duhet të dorëzojë pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, këto dokumenta:

1. Kërkesë ku të jetë përcaktuar pozicioni i punës për të cilin ai konkuron;
2. Diplomë origjinale + fletë notash/fotokopje e noterizuar (shkollë e lartë në profilin përkatës per arte, mesatare e përgjithshme mbi 8) e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MASR;
3. Çertifikate origjinalee/fotokopje e noterizuar e kualifikimit/specializimit/trajnimin të kryer;
4. Jetëshkrim (CV) shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që vërteton elementët e paraqitur në të (studimet; aktiviteti artistik; pervoja pedagogjike si dhe çmimet dhe vlerësimet...etj);
5. Një projekt – program për lëndën për të cilën konkuron;
6. Diploma ose dëshmi në veprimtari të ndryshme profesionale;
7. Dëshmia mbi zotërimin e një gjuhe të huaj (e preferuar anglisht)/bëjnë përjashtim kandidatët që kanë kryer studimet jashtë shqipërie;
8. Të vërtetojë që ka përvojë mësimdhënie në IAL;
9. Dy referenca nga profesorë/personalitetete te fushës;
10. Vërtetim nga qendra/t e punës së mëparshme që nuk ka penalitete në drejtim të etikës profesionale dhe marrëdhënieve me kolegët;
11. Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit;
12. Kopje të letërnjoftimit ose kartës së identitetit;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE



13. Çertifikatë familjare/personale;
14. Të deklarojë/dëshmojë që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata, brenda ose jashtë Shqipërie;
15. Dëshmi e gjendjes mjeksore.

Konkurimi për punonjës mësimorë sa më lartë do të zhvillohet në dy Faza:

(Vlerësimi maksimal 100 pikë)

1.1. Faza e parë - Shqyrtimi i dosjes së kandidatit;

1.2. Faza e dytë - Mësim i Hapur/Intervistë.

Konkurimi do të bazohet në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e AL në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Procedurave Administrative, Kodin e Punës në RSH, Statusin dhe Statutin e Universitetit të Arteve.

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Universitetin e Arteve nga data **12/10/2021** deri më datë **25/10/2021** ora **14.00**.

Për datën e Konkursit kandidatët të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore çdo ditë nga ora **08.00** deri **14.00**.

Prof. Kastriot CAUSHI



REKTOR

UNIVERSITETI I ARTEVE